



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

## Kontabiliteti EKB0014

Data e aprovimit:	Data
Verzioni:	Verzion
ECTS:	9
Bartësi i lëndës:	Isren Fejzullahu
Email:	isren.fejzullahu@riinvest.net
Telefoni:	038 224 322

### Hyrje:

Njohurit bazike për evidencat kontabël dhe raportimet financiare të cilat janë mëse të nevojshme për studentët e ekonomisë përfitohen nga kjo lëndë mësimore. Kjo lëndë u jep studentëve konceptet dhe njohuritë themelore të Kontabilitetit, të cilat janë të domosdoshme për çdo student të ekonomisë, pavarësisht nga drejtimi të cilin e kanë të zgjedhur. Kuptimi, analizimi dhe evidentimi i ngjarjeve ekonomike ne biznese fitimprurëse dhe ne organizata jofitimprurëse do është detyra kryesore e kësaj lënde.

### Qëllimet

Kjo lëndë ka për qëllim që ti pajisë studentët me njohuritë bazë mbi rolet dhe funksionimin e kontabilitetit në një organizatë biznesi. • Të analizojë në mënyrë të detajuar të dhenat me të cilat operojnë organizatat me qëllim që vendimet manaxheriale të jenë me një nivel të lartë efektiviteti manaxherial. • Të orientojë studentët që të dinë të përdorin në mënyrë racionale teknikat ndihmëse në funksion të përmirësimit të cilësisë së manaxhimit. • Ta aftësojë studentin që njohuritë e fituara gjatë këtij kursi t'i përdore në funksion të shtimit të shkathtësive të tij dhe njëkohësisht të orientohej me sukses në praktikat e biznesit.

### Rezultatet e pritura të lëndës

- Të njohin zhvillimin historik të kontabilitetit dhe procesit të evidentimit të transaksioneve ekonomike.
- Të njohin veçoritë kryesore të kontabilitetit bashkëkohor
- Të njohin veçoritë kryesore të kontabilitetit bashkëkohor
- Të përgatisin raporte financiare
- Të evidentojnë dhe prezantojnë të dhënat financiare të organizative
- Të komentojnë dhe kontrollojnë të dhënat financiare të organizative

### Programi

Java	Tema	Aktivitetet
------	------	-------------

1	Objektivi i lëndës-Syllabusi, Sistemi i informacionit kontabël, Prezantimi i Kontabilitetit dhe Bizneseve	Qëllimi i raportimit financiar, Llojet e entiteteve të bizneseve, Natyra, parimet dhe objekti i raportimit financiar, Nevojat e përdoruesve dhe aksionarëve, Elementet themelor të raporteve financiare, Hyrje në Kontabilitet
2	Korniza Rregullative dhe Konventat e Kontabilitetit	Sistemi rregullativ, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK/IASB), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare, Korniza Konceptuale e BSNK, Bazat e vlerësimit, SNK 8 Politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet e kontabilitetit dhe gabimet
3	Burimet e kontabilitetit	Roli i dokumenteve burimore, Nevoja për libra të hyrjeve fillestare, Librat e shitjeve dhe të blerjeve ditore, Libri i arkës, Libri i parave të vogla
4	Ekuacioni i kontabilitetit të dyfishtë	Ekuacioni i kontabilitetit, Librat kryesor, Llogarimbajtja me regjistrim të dyfishtë, Ditarët
5	Analiza e transaksioneve në biznes	Debitë dhe kreditë, Llojet e transaksioneve, Zgjerimi i ekuacionit kontabël
6	Pasqyrat financiare	Bilanci vërtetues, Pasqyra e të ardhurave, Bilanci i gjendjes, Bilancimi i llogarive dhe përgatitja e pasqyrave financiare
7	Kompletimi i ciklit të kontabilitetit	Akrualet dhe parapagimet
8	Kompletimi i ciklit të kontabilitetit	Borxhet e paarkëtueshme, Lejimet për të arkëtueshmet, Provizionet dhe kontigjencat (SNK 37)
9	Inventari i mallit	Natyra e tatimeve në shitje dhe mënyra e mbledhjes së tyre, Kontabilizimi i tatimeve në shitje
10	Inventari i mallit	Kostoja e mallrave të shitur KMSH, Regjistrimi në kontabilitet e stoqeve fillestare dhe përfundimtare, Numërimi i stoqeve, Vlerësimi i stoqeve, SNK 2 Stoqet
11	Inventari i mallit – Blerja e mallrave dhe shërbimeve	Shembuj konkret nga evidentimi furnizimit me mallra dhe shërbime
12	Inventari i mallit – Shitja e mallrave dhe shërbimeve	Shembuj konkret nga evidentimi shitjes së mallrave dhe shërbime
13	Pasuria fikse të trupëzuara	Shpenzimet kapitale dhe të të hyrave, Kontabiliteti për zhvlerësim, Rivlerësimi i pasurive jo-qarkulluese, Nxjerrja nga përdorimi i pasurive jo-qarkulluese, Pasuritë e patundshme, Implantet dhe pajisjet
14	Pasuria fikse të patrupëzuara	Kostot e hulumtimit dhe zhvillimit
15	Sistemi kontabël i kompjuterizuar, Permbledhje përfundimtare e ligjeratave	Prezantimi i një softveri për evidencën kontabile

### Informata shtesë 1:

Gjate ligjeratave do të ketë me teper pjese teorike por do të kombinohet edhe me praktikim të shembujve konkret ne raportin 70% teori dhe 30% praktike. Kurse gjate ushtrimeve kryesisht do të ketë praktikim të detyrave kkonkrete si dhe pak teori sa për të skjaruar shembujt konkret ne raportin 20% teori dhe 80% praktike.

## Informata shesë 2:

Si mjet konkretizimi do te perdoren kompjuteri me projektor per mes prezantimeve te ligjeratave dhe shembujve, do te perdoret edhe tabela e bardhe me marker si dhe ne disa raste tabela interaktive. Gjithashtu studenteve do te ju shperndahen fleta me shembuj dhe detyra te shtypur e te cilat do ti punojne individualisht dhe ne grupe.

## Vlerësimi:

Nr.	Lloji Vleresimit	Perqindja	Pershkrimi
1	Test	45	Në javëne shtatë testimi i pare: Gjendja fillestare të bartet në bilancin e gjendjes; gjendjet të barten edhe nepër llogaritë T. Të regjistrohen deri në 10 ndrrime ekonomike në ditarë dhe në llogaritë T. Të barten gjendjet në Bilancin Provues. Të përpilohet Pasqyra e Të Ardhurave. Të gjendet fitimi sipas aksioneve. Të përpilohet Bilkanci Përfundimtar. Dhe deri në 10% Pyetje me opsione.
2	Test	45	Në javën e katermbdhjetë testimi i dytë: Ndrime ekonomike me detyra për llogaritjen e akrualeve: Të hyrat e pafituara dhe shpenzimet e parapaguara. Kalkulimi dhe kontimi i pagave. Detyra për blerjen dhe shitjen e mallit me llogaritjen e TVSH dhe Doganës dhe kontimi i tyre. Detyra për metodat e llogaritjes se KMSH: Lifo; Fifo dhe Çmimi mesatar. Detyra për metodat e zhvlerësimi dhe amortizimit. Blerja dhe shitja e mjeteve themelore dhe paprekshmërive.
3	Pjesëmarrja	10	Vlerësohet vijueshmëria e studentit por edhe sa ka qenë aktiv në orët mësimore

## Kushtet e përsëritjes:

Studenti duhet qe minimum te kete 40% të pikëve nga testi i parë dhe poashtu edhe nga testi i dytë. Në rast të mos kalimit të këtij minimumi studentit e përsërit testin për të cilin nuk ka arritur minimumin e kërkuar.

## Burimet:

- 1. "Kontabiliteti Financiar (Pjesa e parë)" – Skender Ahmeti, Prishtinë , 2. "P1- Kontabiliteti Financiar" - ShKÇAK 3. "Kontabiliteti Financiar" – Rustem Asllani, Prishtinë 2010, 4. "Kontabiliteti Financiar" Information for Decisions, Prishtinë 2004

## Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	30	
Ushtrime:	30	
L+U:	60	
Seminar/praktike.:	0	
Studim i vazhdushem:	120	
Pregaditja e Provimit:	40	
Pjesemarrja ne teste:	4	
Pjesemarrja ne provimin final:	2	
Me profesorin dhe	10	

asistentin:		
Total Ore:	<b>236</b>	
ECTS:	<b>9</b>	